



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:152624

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05599630

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurve L.. K.. dhe B.. Sh.. për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par 3 nen par 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme PP/II-nr.1217/23 të datës 15.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të hapur për publikun me datë 15.04.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurve L.. K.. dhe mbrojtësi i tije av. Gramoz Zekaj, B.. Sh.. dhe mbrojtësi i tije av. Blerim Ademaj sipas detyrës zyrtare, me datës 18.04.2024 bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 22.04.2024 përpilon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit,**

**L.. K..** i atësisë Z., i amësisë F., e vajzërisë B., i lindur me ..... në P., me vendbanim në fshatin T.. K. P., i martuar baba i dy fëmijëve, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit ....., posedon numër të telefonit ....., i pa punë, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i dënua me parë, mbrohet në liri.

**B.. Sh..** i atësisë B., i amësisë A., e vajzërisë Q., i lindur ... në P., me vendbanim në N., K. P., RR. E.. Sh., i pa punë, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit ....., posedon numër të telefonit ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë, mbrohet në liri.

**JANË FAJTOR**

Për shkak se:

Me datë 09.06.2023, në kohë të panjohur, në paralelen nr. 28 në fshatin S.. të R., K. P, në bashkëkryerje, me qëllim të shitjes, presin trungjet në sasinë prej dy (2) metra kub, në parkun e mbrojtur, në mënyrën që, pasi i pandehuri L., thërret të pandehurin B. për të prerë dru në pyll, pas marrëveshjes në mes tyre që këtë të fundit i pandehuri L. ta paguaj në këmbim të punës në

prerjen e trunqjeve të cilat do të shiten, shkojnë në pyllin në fshatin S.. i cili është pjesë e parkut kombëtar “B.. e N..”, pa leje përkatëse presin katër trunqje të llojit të breut, të njëjtat i ngarkojnë në automjetin e markës “C..” (pickup ngjyrë e bardhë), nisen në drejtim të qytetit të P.. dhe me të arritur rreth orës 21:00 në rr. “K.. S..” tek barriera e pylltarisë, ndalohen nga zyrtarët policor të cilët sekuestrojnë masën drusore nga të pandehurit,

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349, par. 3, nën par. 3.2, lidhur me nenin 31, të KPRK-së..

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 43, 46, 47, 69, 70, 71 par.1 nën par. 1.3, neni 349 par.3 pika 3.1 të KPRK dhe nenin 365 të KPP-së, të pandehurve ju shqipton:

## **DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG DHE DËNIM ME GJOBË**

### **Të pandehurit L.. K..:**

**Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) vit të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 2 (dy) vjetësh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

**Dënim me gjobë** në shumë prej 500,00 € (pesëqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **Të pandehurit B.. Sh..:**

**Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

**Dënim me gjobë** në shumë prej 200,00 € (dyqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse të pandehurit nuk e paguajnë dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do të llogaritet 20 euro.

Të pandehurit secili veç e veç obligohen që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

**I KONFISKOHEN** të pandehurve masa drusore, me vëllim të përgjithshëm prej dy (2) metra kub të llojit breu.

E dëmtuara D.. për A.. e P.. K.. B.. e N.. në P.., për realizimin e kërkesës juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 15.09.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II-nr. 1217/23, ndaj të pandehurve L.. K.. dhe B.. Sh.. për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par 3 nen par 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me propozim që, të bëhet konfiskimi i përhershëm sendeve dhe atë masa drusore dru teknik, prej 2.00 m<sup>3</sup> llojit breu.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 15.04.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurit për të drejtat e tyre për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi të pandehurit kanë hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se të pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata i ka njoftuar te pandehurit për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri L.. K.. është deklaruar se e pranoj fajësinë për veprë penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

I pandehuri B.. Sh.. është deklaruar se e pranoj fajësinë për veprë penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve i plotëson kushtet ligjore, pasi pranimin e fajësisë e kanë bere ne mënyrë vullnetare e po ashtu gjen mbështetje ne provat qe gjenden ne shkresat e lendes dhe gjykatës i propozoj qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve.

Ndërsa mbrojtësi i te pandehurit L.. av. Gramos Zeka deklaron: pasi i mbrojturi im L.. K.. e pranoj fajësinë për veprë penale qe i vihet në barrë në aktakuzë deklaroj se të njëjtën e ka bërë në konsultim me mua si avokat mbrojtës, gjykatës i kërkoj që me rastin shqiptimit të dënimit ti marr parasysh rrethanat lehtësuese si në vijim, pranimin e fajësisë që nga fillimi i kësaj procedure penale, sjelljen dhe bashkëpunimin me organet kompetente, arsyen që e ka shtyrë të njëjtin të ndërmarr atë veprim që ka qenë nevoja për të siguruar të ardhura për shërimin e djalit të tij, keq ardhjen e shfaqur si dhe premtimin se nuk do të kryej këtë ose ndonjë veprë tjetër penale, andaj duke ju referuar të lartcekurave të kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqiptoj ndonjë dënim më gjobë që i përgjigjet gjendjes së tij materiale sepse edhe përmes këtij dënimi do te arrihet qëllimi që parashihet me nenin 38 te KPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit B.. av. Blerim Ademaj deklaron: i mbrojturi im pas konsultimit me të i njëjti fajësinë e pranon në mënyrë vullnetare i cili paraprakisht u njoftua mbi përparësitë dhe pasojat e mos pranimit të fajësisë , i propozoj gjykatës që pranimi i fajësisë te aprovohet . Lidhur me matjen e dënimit gjykatës i propozoj që ti merr parasysh rrethanat e lehtësuese siç është pranimi i fajësisë, hera e parë që bie ndesh me ligjin, kërkim falja dhe premtimi se në të ardhmen nuk do te përsëris veprën penale , i propozoj gjykatës që ndaj të njëjti ti shqiptoj një dënim nën minimumin e paraparë ligjor mundësisht një dënim me gjobë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet në këto prova siç janë: Tetë (8) fotografi nga ku shihet automjeti dhe masa drusore e sekuestruar nga të pandehurit; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëshmitarit në procedurë paraprake, dt. 20.07.2023, Katër (4) fotografi nga vendi i prerjes; Fletëparaqitja e rojtarit të natyrës A.. H., Procesverbali i marrjes së deklaratës së të pandehurit B.. Sh.. dt. 07.09.2023; Procesverbali i marrjes së deklaratës së të pandehurit L.. K.. dt. 07.09.2023, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni n349 par 3 nen par 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin L.. K., gjykata mori pranimin e fajësisë, keqe ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, në bazë të dhënave nga sistemi SML rezulton se i njëjti me parë ka qenë i dënuar me aktgjykimin e kësaj Gjykatë P.nr.130/22 të datës 28.09.2023, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara nga neni 333 par 2. të KPRK-së, P.nr.734/21 të datës20.05.2022, për shkak të veprës penale Shkretim i pyjeve nga neni 348 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Ndërsa për të pandehurin B.. Sh.. si rrethana lehtësuese, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqe ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, në bazë të të dhënave nga sistemi SML rezulton se i njëjti është i pa dënuar me parë, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitat të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në

parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, të pandehurit i obligoi secilin veç e veç që ti paguaj shpenzimet në shumë prej 20,00 €, për paushallit gjyqësor dhe për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Vendimi që të pandehurve t'ju konfiskohet masa drusore dru teknik, prej 2.00 m<sup>3</sup> të llojit breu pa damkë pyjore për transport gjykata e morri duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 235 par. 1 nën par 1.9 të KPRK-së dhe nenit 271 dhe 277 të KPPRK-së, pasi që këto sende janë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale.

Komfor nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2023:152624, 22.04.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

Edona Berisha Kastrati

**G j y q t a r i**

Musë POVATAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate